VENDIM
Nr.258, datë 12.3.2009

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 1.12.2008, PËR ÇËSHTJEN "XHERAJ KUNDËR SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të konventës europiane "Për të drejtat e njeriut", ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 "Për ratifikimin e konventës europiane "Për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore"", të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të datës 1.12.2008, për çështjen nr.37959/02 "Xheraj kundër Shqipërisë", në shumën 2000 (dy mijë) euro.
2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 25 mars 2009.
3. Detyrimi financiar i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
4. Shuma e përcaktuar, si detyrim, në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit Arben Xheraj dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën, kur do të çelet llogaria.
5. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesit, nga Ministria e Financave, të bëhet pas paraqitjes të të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.
6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha